



Pranuar / Dorezuar Priljetat/Prudato Received/Delivery	07.03	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlyerja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPINSHOK	2456/2023		115	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.282/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.282/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.282/2023 e datës 31.01.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 7981/22 i datës 29.12.2022 i Komisionit të Vlerësimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 30.01.2023, përmes postes elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është regjistruar më datë 31.01.2023 nën shenjen A.nr.282/2023, kundër Njoftimit të datës 19.12.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për shpalljen e kandidatit fitues lidhur me Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN000101727, për pozitën e punës Zyrtar i Pasurisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.02.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa, Këshilli më datë 15.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1120/2023 e datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 30.01.2023 nga ankuesja; Akt Emërimit e datës 04.07.2014 për ankuesen; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 19.10.2028 për ankuesen; Certifikatë shkurt 2022; Certifikatë trajnimi qershor 2021; Certifikatën e datës 10.05.2012; CV-në e ankueses; Diplomën e datës 25.06.2008 për ankuesen; Diplomën me Nr. 555/12 të datës 02.11.2012 të ankueses; Konkursin me Nr. Reference RN00010172 të datës 18.10.2022 për pozitën Zyrtar i Pasurisë; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 24.02.2012, 24.02.2015 për ankuesen; Njoftim për kandidatin fitues i datës 19.12.2022; Njoftimin e datës 16.11.2022; Njoftimin e datës 04.11.2022, 16.11.2022, 19.11.2022, 23.12.2022, 30.12.2022 për ankuesen nga SIMBNJ; Vendimin me Nr. Port: 7981/22 të datës 29.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vërtetimin e datës 03.11.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.01.2022 dhe 27.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.02.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 15.02.2023; Lista e renditjes përfundimtare të kandidatëve e datës 19.12.2022; Emailin e datës 30.12.2022 nga F.B për ankuesen; Ankesën e ankueses e datës 23.12.2022 nga ankuesja; Detaje nga rezultatet e vlerësimit në sistemin elektronik; Listën e pyetjeve të intervistës me gojë e datës 05.12.2022; Aplikacionin e kandidates N.B të datës 07.11.2022, Diplomën e datës 23.10.2017, Marrëveshje për shërbime speciale e datës 20.10.2015, 07.11.2016, 08.01.2017, 07.08.2017, Akt Emërimit e datës 11.10.2019, Vendimin me Nr. Prot: 2520/21 të datës 25.06.2021, Vendimin me Nr. Prot: 1535/22 i datës 18.03.2022, Dokument identifikimi, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 31.10.2022, Certifikatën trajnimi e datës 24.08.2021, Vërtetimin e datës 03.11.2022, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i vitit 2021, Formularin e vlerësimit të punës provuese; Aplikacionin e ankueses i datës 04.11.2022; Njoftimin për mbajtjen e intervistës me gojë i datës 30.11.2022 për ankuesen; Vendimin me Nr. Prot: 7245/22 të datës 25.11.2022 për emërimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 18.10.2022 ka publikuar Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN000101727, për pozitën e punës *Zyrtar i Pasurisë-profesional 2*, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja duke u përfshirë në të gjitha fazat e konkurrimit, mirëpo që e njëjta bazuar në Renditjen Përfundimtare të Kandidatëve të datës 19.12.2022 është vlerësuar me gjithsej 79.8 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë në këtë procedurë të rekrutimit. Rrjedhimisht, referuar Njoftimit për Kandidatin Fitues të datës 19.12.2022 rezulton se kandidatja Nuriye Bajrami është shpallur si konkandidate fituese për pozitën e punës *Zyrtar i Pasurisë*.

Ankuesja kundër Njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 19.12.2022, ka parashtruar ankesë fillimisht në Komisionin Vlerësues në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa me datë 30.01.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në ankesën e parashtruar në Këshilli, ankuesja pretendon së Njoftimi i Burimeve Njerëzore të datës 19.12.2022, është nxjerrë në kundërshtim me ligjet në fuqi që rregullojnë punësimin përkatësisht Kushtetutën e Kosovës, Ligjin e Punës, Ligjin për Zyrtaret Publikë dhe Rregulloja për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Propozon që Këshilli të vlerësoj ligjshmërinë e Konkursit me numër reference RN000101727, lidhur me kërkesat e veçanta dhe formale, kërkesat e përgjithshme dhe shqyrtimin e dokumentacionit për aplikim.

Sipas Konkursit për lëvizje me numër reference RN00010172, për pozitën e punës *Zyrtar i Pasurisë* si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare me te paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Fakulteti Ekonomik, sa Përvoja e punës se kërkuar: Se paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit, në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë - Neni 38 me të cilin është përcaktuar se: *"1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni...5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës."*

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës – Neni 41 ka përcaktuar se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2. Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilin aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. Neni 44 më të cilin është përcaktuar se: *"1. Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje..."*. Neni 45 më të cilin është përcaktuar se: *"1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3. Në përfundim të verifikimit*

paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin". Neni 47 përcakton se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet interviestës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të interviestës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të interviestës.. 4.Vlerësimi maksimal në interviestën me gojë është njëqind (100) pike". Neni 48 me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit...". Neni 49 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues..".

Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil- Neni 4 përcakton se: *Kategoritë e pozitive në shërbimin civil* 1. Në pajtim me Ligjin, pozitave të punës në shërbimin civil të Kosovës ndahen në këto kategori funksionale: 1.1. Kategoria e Lartë Drejtuese; 1.2. Kategoria e Mesme Drejtuese; 1.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, dhe 1.4. Kategoria Profesionale., ndërlidhur me këtë Neni 13 i kësaj rregullore ka paraparë se: *Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 "1.Zyrtar i lartë"; Profesional 2 "2. Zyrtar i mesëm" Profesional 3 "3. Zyrtar", Profesional 4 "4. Zyrtar Administrativ",* ndërsa, Shtojca Nr.1/9: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2 ka përcaktuar se: *Kërkesat e Përgjithshme Formale lidhur me këtë kategori janë: a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitave të kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë punë në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar së kushtet për lëvizje brenda kategorisë janë në pajtim me nenin 41 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa kërkesat e veçanta për pozitën e punës janë në pajtim me Shtojca Nr.1/9 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kështu që pretendimet ankimore të ankueses mbi këtë bazë nuk qëndrojnë.

Kolegji i Këshillit ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatës së përzgjedhur dhe ankueses dhe rrjedhimisht ka gjetur se të njëjtat kanë plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë, ndërsa lidhur me kërkesat e veçanta Kolegji bazuar në shqyrtimin e dosjes se aplikimit lidhur me kandidaten Nurije Bajrami ka gjetur së e njëjta posedon Diplomën me numër 169/17 të datës 23.10.2017 për përfundimin e studimeve Menaxhment dhe Ekonomiks, me gjithsej 180 kredi, të lëshuar nga Kolegji Biznesi, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës kandidatja në fjalë ka ofruar dëshmi nga të cilat rezultojnë së e njëjta në bazë të Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta ka punuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për

periudhën nga data 20.10.2015 deri me 20.12.2015, nga data 07.11.2016 deri me datë 06.01.2017, nga data 08.01.2017 deri me datë 07.04.2017 dhe nga data 07.08.2017 deri me 06.01.2018, kurse nga data 11.10.2019 e njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 11.10.2019 është emëruar Zyrtare e Arkivit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Lidhur me ankuesen

Kolegji i Këshillit nga analizimi i dosjes personel të aplikimit ka gjetur së e njëjta sipas Diplomës më numër 555/12 të datës 02.11.2012 ka përfunduar studimet themelore universitare në Programin Banka, Financa dhe Kontabilitet, me gjithsej 180 kredi, në Kolegjin AAB-RIINVEST, ndërsa lidhur me përvojën e punës është konstatuar së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, rrjedhimisht nga data 25.02.2010 deri me datë 04.07.2014 ka ushtruar pozitën e punës Asistente Administrative, ndërsa nga data 04.07.2014 e tutje ushtron pozitën e punës Zyrtarë për Buxhet dhe Financa. Andaj, bazuar në këto fakte rrjedhë së ankuesja si dhe kandidatja fituese kanë plotësuar edhe kërkesat e veçanta për pozitën e punës Zyrtare e Pasurisë, mirëpo bazuar në vlerësimin e intervistës më gojë, kandidatja Nuriye Bajrami është vlerësuar me gjithsej 83.6 pikë, duke u renditur si kandidatja me më shumë pikë, ndërsa ankuesja Teuta Haxhiu-Selimi është vlerësuar me gjithsej 79.8 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë, kështu që mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 44 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *"Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi..."*

Theksuar si me sipër dhe pas konstatimit se nuk janë gjetur shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të procedurës për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00010172 për pozitën e punës Zyrtar i Pasurisë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.282/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.